

Kush jemi ne:

SIT është një organizatë jo-qeveritare e themeluar në vitin 2008 që ka për qëllim të promovojë dhe të krijojë një shoqëri të barabartë për të gjithë. Kështu, ne trajtojmë disa nga problemet më sfiduese në shoqërinë tonë që na pengojnë për të arritur barazi, paqe, dhe zhvillim. Ne synojmë të arrijmë këtë duke përfshirë njerëz të të gjitha prapavijave, pa marrë parasyh gjininë, orientimin seksual apo ndonjë kategori tjetër të identitetit. Për më shumë, vizitoni: www.sit-ks.org

Titulli: Menaxher/e për Media Sociale/Social Media Manager

Orari i punës: Gjysmë orar, 20 orë në javë

Lokacioni: Prishtinë, Kosovë

Përgjegjësi mbikëqyrëse: Jo

Detyrat dhe përgjegjësitë:**Menaxheri/ja për Rrjete Sociale ka këto detyra dhe përgjegjësi:**

- Përdorimi i mjeteve të marketingut të mediave sociale për të krijuar dhe ruajtur identitetin e organizatës;
- Punon ngushtë me anëtarët/et e ekipit për të zhvilluar fushata të marketingut në mediat sociale;
- Menaxhon rrjetet sociale të organizatës si: Facebook, Twitter, Instagram, LinkedIn, TikTok.
- Përditëson faqen e organizatës www.sit-ks.org;
- Përgatitë dhe publikon materiale për promovimin e organizatës, si: fotografi dhe kontent;
- Ndërvepron me palët e treta të interesuara përmes llogarive të mediave sociale të organizatës;
- Analizon dhe implementon strategjinë e komunikimit dhe mediave sociale;
- Hulumton tendencat e mediave sociale dhe informon ekipin për ndryshimet që janë të rëndësishme për aktivitetet e marketingut të organizatës;
- Vendos treguesit kryesorë të performancës (KPI) për fushatat e mediave sociale dhe bën matjen e performancës së një fushate kundrejt KPI-ve;
- Merr pjesë në takimet e rregullta me stafin e SIT, me menaxherë/e të projektit duke diskutuar rezultatet dhe gjetjet si dhe pranon rekomandimet.



Kualifikimet dhe shkathtësitë e detyrueshme:

- Duke përfunduar ose të ketë të përfunduar studimet Bachelor apo Master në programet e shkencave sociale (shkenca politike, punë sociale, sociologji, filozofi, psikologji, etj.) apo fushën e komunikimit – apo të ketë të përfunduar ndonjë trajnim për menaxhimin e rrjeteve sociale;
- Të ketë përvojë të dëshmuar të paktën 1 vit në fushën e rrjeteve sociale dhe të jetë i/e informuar me tema sociale (barazi gjinore, parandalim i dhunës, promovimi i shëndetit të mirë, etj.);
- Të ketë njohuri të avancuara të gjuhës angleze në të folur dhe të shkruar;
- Aftësi të mira organizative, entuziast/e, i/e gatshëm të marrë përsipër përgjegjësi dhe udhëheqësi, i/e pavarur dhe i/e gatshëm të punojë në ekip.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- 1) CV-ja jo më e gjatë se 1 faqe dhe minimum 1 referencë;
- 2) Letër motivimi (në gjuhën shqipe, e preferueshme të jetë edhe në gjuhën angleze);

Vetëm kandidatët/et që do të selektohen në listë të ngushtë do të njoftohen me email!

Dokumentet e nevojshme, mund t'i dërgoni në: apliko@sit-ks.org

Afati i fundit për aplikim: 4 dhjetor 2022

